

“GJELLA E SHËN MËRISË VIRGJËR” E JUL VARIBOBBËS: ÇËSHTJE TË KOMPOZICIONIT

Zeqirja NEZIRI

Katedra e Gjuhës dhe e Letërsisë Shqipe, Fakulteti i Filologjisë,
Universiteti “Shën Cirili dhe Metodi”, Shkup,

MAQEDONI


E-mail: zekoneziri@yahoo.com

PËRMBLEDHJE

Në këtë studim i bëhet një analizë morfologjisë së *Gjellës* së Jul Varibobbës. Përcaktimin e konceptit gjinor mbi të cilin është ngritur kjo vepër e rëndësishme e letërsisë shqipe të shekullit XVIII e konsiderojmë njërin prej faktorëve elementarë që dëshmon për përkatësinë e poetit periudhës së caktuar letrare dhe për përfaqimin prej tij të parimeve teorike letrare të kohës. Mbështetur në veçoritë tematike, kompozicionale dhe stilore të *Gjellës* së Varibobbës autori ka ngritur hipotezën se kjo vepër letrare është ndërtuar duke pasur pikënisje këto tri grupe llojesh letrare të letërsisë fetare: veprime ligjërimore zakonore (lutja, rrëfimi, ankimi, qortimi, besimi, bekimi, mallkimi), fillesa të gojëtarisë kishtarë (predikimi, numërimi litanik) dhe forma të letërsisë didaktike fetare (mësimi fetar, traktati). Duke mbajtur qëndrim kritik shkencor ndaj studimeve të deritanishme (N. Resuli, Z. Kodra, Sh. Demiraj, I.C. Fortino, R. Elsie, A. Xhiku, K. Kodra, A. Berisha, V. Belmonte), me këtë vepër të Varibobbës në letërsinë shqipe të shekullit XVIII shohim jo vetëm një kompozicion cilësor, por edhe një risi në komponimin e veprës letrare, duke konsideruar se ky sistem i ri i kompozicionit të *Gjellës* duhet kuptuar dhe interpretuar drejt e si duhet. Varibobba komponon në të kundërtën e Moliërit

dhe të Aristotelit. Në vend të “l’Union”, ai do ta sjellë inkoherencën e quajtur “morcelacion” dhe në vend që episodet t’i konsiderojë diç të pa rëndësishme, që vijnë prapa, ato i konsideron qenësore, që duhet të merren si pikënisje,

si elemente themelore të komponimit. Analiza e këtij parimi krijues i Varibobbës ndihmon pastaj gjetjen e një shpjegimi të logjikshëm edhe të një vargu të madh çështjes që lidhen me konceptin e poetit për ndërtimin e mesazhit poetik, mënyrën e shprehjes së individualitetit të tij krijues, mënyrën e paraqitjes së botës poetike, mënyrën e bartjes së faksionit biblik në fiksion letrar, mënyrën e ndërtimit e të funksionimit të figuracionit poetik dhe, duke u zbritur këto çështje, të qartësohen pikëpamjet e deritanishme



të studimit, sidomos të periodizimit të letërsisë shqipe deri te Rilindja Kombëtare dhe, në kontekst të letërsisë së përgjithshme evropiane, të përfshirjes së saj brenda simetrisë së kufijve të përgjithshëm të periodizimit të letërsisë në përgjithësi.

Fjalët kyçe: *Gjella e Shën Mërisë' Virgjër, probleme të zhanrit, klasifikim, poemë, litani, predikim, letërsi shqipe, letërsi evropiane.*

Key words: *The Life of St. Mary the Virgin, genre problems, classification (taxonomy), poem, preaching, Albanian literature, European literature.*

Parimi i kompozicionit sipas të cilit është ndërtuar veprimi i *Gjellës së Shën Mërisë Virgjër* të Varibobbës është arsyeja që na ka udhëhequr drejt zbrërthimit të elementëve formësues zhanrorë të tekstit historik letrar të vendosur në kohën e Iluminizmit letrar shqiptar. Mbështetur në studimet e sotme letrare të mënyrës së ndërtimit të lëndës artistike është nënvizuar se asnjë lexim serioz nuk do të jetë i suksesshëm nëse nuk njihen *llojet dytësorë*, të cilët bashkëveprojnë dhe ndihmojnë krijuesin në ndërtimin e strukturës kompozicionale të llojit letrar kryesor, pra *parësor*.

Në studimet e derisotme historike letrare shqiptare, tekstet letrare në aspektin e ndërtimit zhanror, jo vetëm që nuk janë lexuar në mënyrë precise, por shumë prej tyre, për fat të keq nuk janë lexuar fare. Kjo çështje paraqet njërin prej problemeve më të panjohur dhe më të pastudiuar të letërsisë shqipe në përgjithësi. Është e vërtetë se studiuesit e deritanishëm, të cilët kanë studiuar si problematikën e Iluminizmit, ashtu edhe sistemin zhanror të tijin, kanë prekur edhe problemin e varieteteve të letërsisë shqipe të shekullit të 18. Letërsia shqipe e pararilindjes Kombëtare është studiuar pjesërisht dhe ne sot e dijmë se nuk janë studiuar si dhe sa duhet krijuesit fetarë e kishtarë të lëvizjes së Kundëreformës, pastaj shkrimtarët, thënë me kusht, e Romantizmit Klasicist të periudhës së Iluminizmit.

Gjella e Varibobbës shumë herët është bërë lëndë e hulumtimit në shkencën tonë të letërsisë. Përgjithësisht të gjithë studiuesit janë përqendruar në konstatimin e paraqitjes së poetit në

fillim dhe në fund të tekstit dhe në theksimin e *situatës së folur monologjike* të Shën Mërisë si karakteristikë kryesore të çdo *vajtimi* veçanërisht dhe të veprës në tërësi. Mirëpo, një ndarje e këtyllë e tekstit në të folurit e autorit dhe në të folurit e figurës nuk është bërë objekt studimi i tërësisë së zërave, të cilët paraqiten në të. Duke mbetur vetëm në skemën dypjesëshe mund të vërejmë folësit, të cilët heroina kryesore i ka përshkrirë në monologun e vet, por që nuk janë identikë as me të as me poetin.

Meqë nuk mund të pranohen në tërësi analizat të cilat kanë veçuar vetëm ndërtimin monologjik të shprehjes (vepra dëshmon organizim treshtresor të ligjërit), mendojmë se nuk është e mjaftueshme ta komentojmë vetëm karakterin *rrëfimor* të saj. Jo vetëm për temën, e cila problematizon "*kategoritë themelore të besimit të krishterë - mëkatit - pendesën dhe pranimin e mëkatit*", por edhe për shkakun se në vepër një pjesë e rëndësishme e tekstit formohet sipas modelit të procesit të ritualit të krishterë: sipas shembullit të *ligjërit*, të *lutjes* ose të *rrëfimit*. Për zbatimin e ndonjë analize serioze gjinologjike, mund të presupozohet se nuk janë të mjaftueshëm termat e deritanishëm: *poemë religjioze*, me të cilin është mbuluar teksti integral i *Gjellës dhe vajtimit* si shenjëzues i ndonjë kënge të poemave religjioze.

Analiza jonë zhanrore e veprës së Varibobbës, me të cilën është përshkruar struktura gjinore e secilës njësi kompozicionale tregoi se pjesët më të mëdha të tekstit janë realizuar me ndihmën e zhanreve dytësore, të cilët, mbështetur në karakteristikat e tyre tematike, kompozicionale dhe stilore, i kemi ndarë në tri grupe: *tekste rituale folëse* (lutja, rrëfimi), *tekste themelore të retorikës kishtarë* (ligjërim, numërime litanike) dhe *tekste të letërsisë fetare didaktike* (mësime fetare, predikim). Do theksuar se asnjë vepër e letërsisë fetare, në pikëpamje të llojit letrar, nuk është e pastërt. Të gjithë, do thoshim, janë *hibridë*, sepse në to ose radhiten nga disa zhanre dytësore, të cilët këmbehen midis tyre, ose zhanri themelor shkurtimisht ndërpritet me "*ndërfutjen*" e zhanrit të dytë, si është rasti te *kënga e parë* e Varibobbës, në të cilën lutjet ndërfiten

brenda tekstit rrëfimor. Një shembull i këtellë tipik dhe më i dukshëm paraqitet atëherë kur poeti përshkruan udhëtimin jetësor të Shën Mërisë. Në vija të përgjithshme përshkruhet lindja, vendosja në kuvend, bindja, ngjizja dhe kthyerja e Shën Mërisë në mjedisin shoqëror: shkuarja te Elizabeta (vargjet 29-92). Në momentet kur pritet të vazhdohet narracioni ndërpritet me *lavdin* e Elizabetës (vargjet 93-104) dhe me predikimin e poetit (shpjegimi i shenjtërimin të Shën Mërisë: vargjet 105-120). Vazhdon me arsyetimin e thashethënave (vargjet 121-132). Që në vargjet vijuese 133-140 të jepet një *lavd – lutje* e poetit për Shën Mërinë: lavdërohet pastërtia e saj shpirtërore dhe lutja e poetit të flerë në prehërin e saj. Në vargjet vijuese (141-172), nga lexuesi pritet të vazhdohet rrëfimi i udhëtimit jetësor të Shën Mërisë, që ishte ndërprerë në vargun 132, ndërkaq, në formë të *këngës kishtare*, poeti rrëfimin e bart te Shën Mëria dhe kjo nëpërmjet kësaj kënge predikon mësimet e krishtera. Kënga e saj është realizuar si një mësim kishtar për mëshirën e të Shenjtës Trini, ndëshkimin e të pabindurve dhe shpërblimin e të bindurve, për dallimet shoqërore (të varfër të pastër) dhe përfundon me një histori të shkurtër të historisë biblike nga Adami deri te Abrahami. E gjithë kjo pjesë e rrëfimit shoqërohet me një *sentencë / këshillë* e Shën Mërisë: kush i këndon sheqerit e fiton devotshmërinë.

Ky meditim i shkurtër për karakteristikat zhanrore të poemës religjioze vërtetojnë dyshimin tonë të thënë më parë në mundësitë e zbatimit të analizës së tërësishme zhanrore duke shfrytëzuar terma gjinologjikë. Do të shtojmë se pikërisht shtresa religjioze, e veçuar në analizat e deritanishme, me harmonizimin e zhanreve dytësore, është shumë e afërt me strukturën gjinologjike të *Gjellës*. Megjithatë vjershërimi është i ndarë në 32 këngë dhe ka 4717 vargje, pjesët e tij janë të koncentruar, sipas gjykimit tonë, rreth *tri fushave të mëdha narrative* të lidhura me aktantin e përbashkët Shën Mërinë dhe materializimin e pastërtisë së saj hyjnore. *Fusha e parë* (I-IV) është e lidhur me lindjen e Krishtit, gjegjësisht krishterimit; *fusha e dytë* (V-X), në kohë, e afërt me të parën, problema-

tizon hyjnizimin e qenies së Shën Mërisë dhe praktikën e krishterimit; ndërkaq *fusha e tretë* (XI-XXXII) hyjnizimin praktik të veprës së saj – nënë e Krishtit dhe e krishterimit. Komponente historike dhe religjioze është e pranishme në të tri fushat narrative. Leximi përshkrimor i vjershërimit do të ndriçojë edhe *koherenten*, d.m.th. *organizimin narrativ* të vjershërimit dhe njëkohësisht grumbullimin e të dhënave të nevojshme për zbatimin e *analizës gjinologjike*, e cila paraqet qëllimin e leximit tonë të *Gjellës*.

PARËSORJA NDËRTOHET NGA POZITA E DYTËSORES

Njëra ndër risitë më të mëdha gjinore të Varibobbës është parimi i ndërtimit të kompozicionit ose i strukturës së organizimit të subjektit të veprës, e cila është rezultat i shpërputhjeve me tipin klasik të kompozicionit të paraqitura në fund të shekullit XVII dhe pikëpamjeve të përsosura përgjatë shekullit XVIII (Peiç:115).

Poeti francez Jauqes Baron Rousseau, në shekullin XVIII, rëndësi të madhe i jepte shpërputhjeve gjinore me idealin antik të kompozicionit. Me këtë dëshmohet se, në shekullin XVIII u shpërbë idealin klasik i kompozicionit: ndërpritet uniteti i brendshëm i veprës artistike. Në vend të koherencës klasike të quajtur “*concinitas*” (Vitruvi, Alberti) paraqitet inkoherenca e quajtur “*morcelacion*” i veprës artistike.

Pjesa më e madhe e studiuesve që shkruanin për kompozicionin e *Gjellës* së Varibobbës e kanë vlerësuar atë sipas idealit klasik të kompozicionit, të cilin Moliëri e quajti me emrin “*l’Union*”, kurse Aristoteli, më parë theksonte: “Fillimisht bëni fabulën, ndërkaq për episodet që duhet të zgjerohen, mendoni më vonë”.

Varibobba komponon totalisht në të kundërtën e Moliërit dhe të Aristotelit. Në vend të “*l’Union*”, ai do ta sjellë *morcelacionin* dhe në vend që episodet t’i konsiderojë diç të parëndësishme, që vijnë prapa, ai episodet i konsideron qenësore, që duhet të merren si nismëtare, si themel i komponimit.

Duke mos vlerësuar kompozicionin e Varibobbës nga pozitat e sistemit iluminist, por sipas sistemit klasik të komponimit, studiuesit shqiptarë, përveç ndonjërit (Klara Kodra e An-

ton Berisha) sa nuk thonë se Varibobba nuk di as të komponojë. Flitet për mungesën e unitetit, për parregullsinë, ndaj edhe për shkujdesjen. Përkundër tyre, ne në të shohim jo vetëm një komponim cilësor, por edhe risinë e komponimit në letërsinë shqipe të shekullit XVIII, duke konsideruar se ky sistem i ri iluminist i komponimit i Varibobbës duhet kuptuar si duhet. Varibobbën e respektojmë si e respektojmë shkrimin e një Saint Lambert – i me komponimin e tij “të parregullt (jounik)” pranë komponimit unik të shkrimeve të një Homeri, Danteje, Ariostoje apo Tassoje.

Moda e thyerjes së unitetit në veprat artistike që vërehet në të gjitha artet e shekullit XVIII, ka depërtuar edhe në letërsinë e këtij shekulli. Në vend të unitetit tipik klasik të komponimit të epit (poemës), paraqitet tipi modern, për kohën, i komponimit të poemave të morceluara ose edhe paraqitja e këngëve të vogla si *madrigali*, *epigrami*, *oda*, *shamsona*.

Gjella e Varibobbës, si edhe shumë vepra të shekullit XVIII me sistemin modern të komponimit me ndihmën e skenave dytësore – shëmbëllen me të gjitha veprat letrare të letërsive të tjera evropiane, si të letërsisë fetare franceze, italiane e spanjolle, ashtu edhe të letërsisë fetare gjermane e angleze të këtij shekulli. Poeti është i stërmbushur me çmendurinë e fjalëve dhe ghirlandën e strofave, përshkrimet medalonike të natyrës, pasqyrës, veshjes, portretit të njerëzve, përshkrimet e detajuara të veshjes së Bambinit, të luleve dhe të dhuratave. Në *Gjellën* e Varibobbës syri nuk udhëhiqet me simetralen e veprimit kryesor në vepër, por kënaqet në sharmin special iluminist: endja në të panjohurën, në magjishmërinë e takimeve të papritura, në ëmbëlsinë e skenave dytësore, si dhe në gëzimin e veçantë: në vdekjen e ëmbël në gjirin e besimit të krishterë; humbjen e rrjedhës së rrëfimit (në dukje) në labirintin gjuhësor. Një modë e tillë në letërsi është e pranishme në rend të parë në stilin epistolar nga Montesquieu deri te Laclosi, mandej në kompozicionin mozaik të mendimeve dhe të croquisit moral të tipit të Chamfortit. *Candidi* i Volterit është shembull i vërtetë i modës se morcelimit: është i komponuar me inkrustrimin e kapitujve.

ESTETIKA E EPISODIT

Origjinaliteti më i madh i komponimit të vjershërimit të Varibobbës është bindja e tij se veprimi kryesor nuk është themelor dhe qendër e kompozicionit, por themelore dhe qendër të komponimit ai i konsideron skenat dytësore – episodet, të cilat i realizon me anë të *ndërhyrjeve* – në formë të *lutjeve* ose *lavdeve*, të *predikimeve* ose *mësimeve fetare* si mjete artistike. Këtë mjet teknik të parësore në dytësore, ndërtimin e veprimit kryesor nga veprimi episodik – të rrallët e kanë kuptuar si risi dhe origjinalitet të Varibobbës. Në vend që te ai ta shohin poetin shqiptar pendan Gillot-it, Audran-it ose cilitdo mjeshtër të ornamentit të shekullit XVIII, te Varibobba kanë parë kompozitorin e pakujdesshëm, të paafhtë t’ia nënshtrorë dytësoren episodike veprimit kryesor.

Moda e shekullit – pikëpamja e kryesore në dytësore – është e kundërt me pikëpamjen e sh. Augustinit: “Omnis porro pulchritudinis forma, unitas est”. Sidomos ka qenë e dashur në teatrin e shekullit XVIII. Paraqitet si i a.q. “l’interlude”, intermexo në operë. Kështu valltarja e famshme e *La Barberin-it* (1721-1799), me pikat e saj të baletit dhe pantomimës, paraqet formalisht skenën dytësore, ndërkaq de facto e ka paraqitur veprimin kryesor të operës. Kjo e shtyri J.J. Russonë të shkruajë se këto janë *divertissements* “qui se succèdent sans sujet nmi liaisons entre elles, ni avec l’action principale”.

Këto “die Zwischenspiele” dhe këto “extempores” – janë ëmbëlsi e veçantë e komponimit modern të kohës së Varibobbës. Sikurse që në tapiserinë ose në gravurën e shekullit XVIII, bordura paraqet esencën, kurse fotografia kryesore dytësoren, kështu te Varibobba qindra “sporaditete” të egra si: përshkrimi i dimrit, i shpellës dhe i karikimit të Dioklecianit apo Erodit, ose përshkrimi i tualetit të Krishtit – paraqesin esencën poetike, kurse vetë veprimi i *Gjellës*, përmbajtja e vjershërimit, paraqet dytësoritetin.

Disa vargje të Varibobbës janë vinjeta të pastra poetike, shprehje e gëzimit të thjeshtë të shkrimit, vetëm tejbartje, si dhe komedijim i fjalëve, shpesh pa ndërlidhje shkakore me mendimin kryesor, dominanten e kompozicionit.

Lloji letrar	Vargjet	Lënda
Lutje	1 – 4	Bekimi i shën Mërisë për vjersherimin
Lavd	5 – 20	Pastërtia shpirtërore. Grua e destinuar për hyjnzim
Pershkrim	21 – 24	Dëshira e prindërve për fëmijë
Lutje	25 – 28	Për fëmijë: Ana për sh.M.
		Bloku tematik i shën Mërisë
Pershkrim	29 – 36	Lindja: festojnë qielli e toka dhe Mbyllja në kuvend
Lavd	37 – 40	Shenjtërimi i shën Mërisë
		Bloku tematik i bindjes
Predikim	41 – 42	Engjëlli sjell lajmin
Pershkrim	43 – 48	Dialogu i shën Mërisë me engjëllin
Bindje	49 – 52	Engjëlli: Zoti e çmon singjertetin
Predikim	53 – 56	Këshillë: Zoti kujdeset për ty
Pajtim	57 – 60	Shën Mëria pajtohet me kusht: t'i ruhet djali
		Bloku tematik i ngjizjes
Pershkrim	61 – 68	Ngjizja e shën Mërisë: hapja e qiellit
Lavd	69 – 92	Depersonalizomi: Krishti zot i zemrës
		Bloku tematik i shën Mërisë dhe Elizabetës
Pershkrim	93 – 104	Sh. M. shkon te Elizabeta. Gëzimi dhe singjerteteti i kësaj
Lavd	105 – 120	Perspektiva e Elizabetës = lavd për ngjizjen e ShM
		Sekreti i ngjizjes
Pershkrim	121 – 132	Përhapja e thashethënave: prejhe në pafajësi, jo e përdale
Lutje	133 – 140	E ndëruar dhe e bekuar. Poeti do të flerë në preherin e saj
		Kënga e shën Mërisë në formë të lutjes
Predikim	141 – 160	Mëshira e të shenjtës Trini Krijimi i njeriut: ndëshkimi shpërblimi
Mësim fetar	161 – 172	Të pasurit vdesin urie ⇔ të varfërit ngopen me bukë gruri. Iu premtua dhe iu dhurua Adamit, Abrahamit dhe pasardhësve
Sentencë	173 – 176	E shën Mërisë: kush i këndon sheqerit e fiton devotshmërinë
		Bloku tematik i shën Mërisë dhe Elizabetës
Pershkrim	177 – 184	Elizabeta e strehon sh. M. tre muaj. E ndihmoi në lindjen e Janit
Lavd	185 – 188	Lavd figurës së Janit
Pershkrim	189 – 192	Ndaria me Elizabetën
		Bloku tematik i shën Mërisë me Zefin
Pershkrim	193 – 196	Kthyerja në shtëpi: Ndaria me Elizabetë i rregohet Zefit
		Bloku tematik i Zefit
Pershkrim	197 – 208	Zemërimi i Zefit: nuk i tregoi për barkun. Flet me vetveten
	209 – 232	Zefi e di për engjëllin C' është kjo?
	233 – 234	Mori mietet e punës dhe doli
		Bloku tematik i shën Mërisë për Zefin
Pershkrim	235 – 236	Shën Mëria qanë dhe përkëdele barkun
	237 – 238	Ai nuk shkoi para agimit: ndërtoje
	239 – 240	Shën Mëria gjithë natën qau hallin e saj
Lutje	241 – 248	I lutet Zotit ta ndihmojë këtë dhe ta mëshirojë Zefin
		Bloku tematik i engjëllit dhe Josifit
Qortim	249 – 260	Paraqitja e engjëllit në ëndërr
Bindja	261 – 272	Njerzëti do ta kenë zili për këtë grua që ka
Porosi	273 – 276	T' i kërkojë falje sh. Mërisë dhe fëmijën ta pagëzojë Jezu
Pendësë	277 – 288	Zefit zgjohet, pranon gabimin: të varet apo të pijë
		Bloku tematik i Zefit me shën Mërinë
Rrëfim	289 – 292	Bëret në vaj: i kërkon të falur shën Mërisë
Qortim	293 – 313	E qorton: të rrjje me të ose jo. Pse i zemërohet Zotit. Pajtohen.
		Bloku tematik i lindjes së Krishtit
Lutje	314 – 316	E falënderojnë Krishtin që ka vendosur të vijë te ata
Pershkrim	317 – 328	Nisin përgatitjet: shën Mëria përgatit pelenat, Zefi bën djepin
Lavd	329 – 332	Lavdërohet ardhja e Krishtit
Pershkrim	333 – 340	Duhet të shkojnë në qytet t'i regjistrojnë taksat
	341 – 350	Është dhjetori
	345 – 350	Sh. M. i jep zemër Zefit. Ky është i zemëruar.
Lutje	351 – 352	Shën Mëria lutet
Pershkrim	353 – 356	Ngarkojnë gomarin dhe nisen
	357 – 360	Veshja e shën Mërisë
	361 – 368	Arritja në Betelem. Stehimi në shpellë
Pershkrim	369 – 372	Lindja e mjerrë e Krishtit dhe lindja elegante e të pasurve
	373 – 376	Përgatitjet e Zefit në shpellë: ndez zjarrin
	377 – 380	Shën Mëria pastron shpellën
Lutje	381 – 384	Lutja e Zefit.
	385 – 392	Lutja e shën Mërisë
Pershkrim	393 – 396	Ka ardhur koha e lindjes: shën Mëria bisedon me fëmijën në bark
	397 – 408	Në mesnatë prishtet qetësia. Lindja e Bambinit
		Bloku tematik i manifestimit të lindjes së Bambinit
	409 – 428	Gëzimi i shën Mërisë pas lindjes
Lutje poeti	429 – 436	Ndërhyrja: si u ndje shën Mëria?
Pershkrim	437 – 444	Zbritja e engjëjve
	445 – 452	Gëzimit të Zefit
	453 – 464	Përhapja e laimit nga engjëlli
	465 – 496	Përgatitjet e fshatarëve
Urim	497 – 510	Urimet e shenjtëorëve
Lutje	511 – 512	Piesa e engjëjve për vallezim
Bekim	513 – 516	Bekimi i dhuratave nga shën Mëria
Pershkrim	517 – 520	Takimi i barinjve dhe i engjëjve me Bambinin
	521 – 524	Përhapja e laimit

Llojet letrare dytësore të këngës së parë

Ky “mënjanim” dhe kjo “kthyerje e shpinës” në qoftë se nuk shihet si vepër e sistemit të ri të komponimit, por si gabim ndaj sistemit klasik të komponimit – do të thoshte t’i bësh një gabim të pafalshëm gjenit të Varibobbës.

MODA E KOMPILIMIT

Shekulli XVIII e do kompilimin. Edhe Varibobba veten e quan “radhitës”. Por, pranë observatorit të madh të natyrës, ai është edhe kompilator i madh, i cili lexon shumë e me shije dhe shpesh shërbehet me ekscerptin dhe marginalitet: “nga libra të ndryshëm është nxjerrë jetëshkrimi i shkurtër i Shën Mërisë”. Thuhet shkurtimisht nga studiuesit se Varibobba është nën ndikimin e poetëve kishtarë italianë ose spanjollë dhe shumë gjerësisht se është nën ndikimin e letërsisë kishtarë. Ai duke shkruar në frymën e modës kompilatore të shekullit XVIII, asimilon një numër shumë më të madh – që është shumë e rëndësishme për zhvillimin e letërsisë së tij – autorësh vendimtarë, në rend të parë Biblën, pastaj shkrimtarët grekë: parodistët si Homer, Hesiodi, Aristofani; poetët latinë: Virgjilin dhe sidomos Ovidin; patristikën, Acta Sanctorum; poetët bizantinë dhe sidomos udhëheqësit e urdhrit të tij Ignacio Loyol-ën, Shën Terezën. Përpunon, si thotë edhe vetë, katekizmin e kardinal Bellarminit dhe shërbehet me historinë e kishës nga Fleury.

Mund të shkruhet shumë për kompilimet e Varibobbës, në të cilën kurrsesi nuk mund të përjashtohet edhe prania e poezisë gojore arbëreshe në poetin e *Gjellës së Shën Mërisë Virgjër*, si dhe të letërsisë paraprake shqipe, sidomos atë të Pjetër Budit.

Shikuar në aspektin kompozicional ç’është *Gjella*? Poemë? Epistolë? Buffa religjioze? Skenar për operë comique? Është vështirë t’i jepet një emër i saktë këtij albumi të jashtëzakonshëm të fotografive të observuara me këso mbështetje të madhe, citate dhe marginalie nga kaç shumë libra të lexuar. Ndoshta emërtim më i mirë do të ishte termi që përdor Varibobba: *vjersh - këngë*. Ne sot do të thoshim: **spektakël**. Dhe vërtetë ai shkruan një mori urimesh fshatare, shkruan shown e engjëjve. Në fund duhet të thuhet se *Gjella* e Varibobbës, në pjesën më të madhe skemën kompozicionale e trashëgon nga *Autobiografia* dhe *Exercita spiritualia* të Loyolës. Pra, nëse lloji parësor i vjersherimit është *poema*, ai nuk është ndërtuar në mënyrë klasike sipas rrjedhës lineare të ndërtimit të rrëfimit, por me ndërhyrje shumë të shpeshta të

Ilojeve dytësore. Kjo teknikë është një risi e kohës, e cila shënon edhe një shmangie nga tradita.

BIBLIOGRAFIA

BERISHA, A. (2002), *Gjella e Shën Mëris Virgjër e Jul Varibobës*, Faik Konica & Shpresa, Prishtinë.

CURTIUS, E.R. (1971), *Evropska književnost i latinsko srednjovekovlje*, Zagreb.

DEMIRAJ, Sh. (1958), *Jul Variboba (1762)*: Buletin i Shkencave, 1958, 1, Tiranë.

DOMI, M. (red. 1959), *Historia e letërsisë shqipe I*, Tiranë.

FORTINO, I.C. (1984), "Prolegomeni": Giulio Varibobba, *La vita di Maria*, Cosenza.

HAMITI, S. (1989), *Vetëdija letrare. (Sprova për një Poetikë) 4*, Rilindja, Prishtinë, 9-42.

JAUSS, H.R. (1970), *Teorija rodova i književnost srednjega vijeka*, "Umjetnost riječi", Zagreb, 14/1970, 3, 327-352.

PEIĆ, M. (1972), "Barok i rokoko u djelu Antuan Kanižliča": *RAD JAZU 365. Razred književnosti*. Zagreb: 5-133.

UÇI, A. (2004), *Filozofia e T.A. Kavalitit*, Tiranë.

VARIBOBBA, G. (1984), *La vita di Maria*, Cosenza.

VARIBOBBA, G. (2005), *Vita della Beata Vergine Maria (1762)*, Rubbettino, Soveria Mannelli (Catanzaro).

XHIKU, A. (red. 1983, 1989), *Historia e letërsisë shqiptare*, Tiranë; Prishtinë.